

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 359/13

Data: 13 mars 2014

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe gjyqtarit kosovar të Gjykatës së Apelit, Fillim Skoro, si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjor të EULEX-it Beti Hohler, zyrtare ligjore e EULEX-it,

në procedurën penale kundër

- 1. S.L.**, emri i të atit M, i lindur më xxx në fshatin P.I.U, me vendbanim në S, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me numër të letërnjoftimit xxx, xxx

sipas aktakuzës së ndryshuar nr. PPS 10/11 e ngritur më 24.10.2012 i akuzuar për Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, sipas nenit 158(1) të lexuar me nenin 23 të Kodit penal të Kosovës, në fuqi deri më 1.1.2013 (KPK) (pika 1 e aktakuzës) dhe Kanosje sipas nenit 161(1)(2) dhe (4) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pika 5 e aktakuzës);

- 2. R. H.1.** emri i të atit N, i lindur më xxx në K. e M, me vendbanim në P, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me profesion xxx,

sipas aktakuzës së ndryshuar nr. PPS 10/11 e ngritur më 24.10.2012 i akuzuar për Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, sipas nenit 158(1) KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pikat 1-4 të aktakuzës) dhe Kanosje sipas nenit 161(1)(2) dhe (4) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pikat 5-8 të aktakuzës);

- 3. A.A.**, emri i të atit T, i lindur më xxx në fshatin T, komuna e P, me vendbanim në P, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës,

sipas aktakuzës së ndryshuar nr. PPS 10/11 e ngritur më 24.10.2012 i akuzuar për Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, sipas nenit 158(1) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pikat 1-4 të aktakuzës) dhe Kanosje sipas nenit 161(1)(2) dhe (4) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pikat 5-8 të aktakuzës);

4. **R. H.2.** emri i të atit K, i lindur më xxx në fshatin D në komunën e G. me vendbanim në P, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me profesion xxx,

sipas aktakuzës së ndryshuar nr. PPS 10/11 e ngritur më xxx i akuzuar për Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, sipas nenit 158(1) të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pika 2 e aktakuzës) dhe Kanosje sipas nenit 161(1)(2) dhe (4) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pika 6 e aktakuzës);

5. **Q. M.** emri i të atit A, i lindur më xxx në K, M, me vendbanim në P, shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me profesion xxx,

sipas aktakuzës së ndryshuar nr. PPS 10/11 e ngritur më 24.10.2012 i akuzuar për Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, sipas nenit 158(1) të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës) dhe Kanosje sipas nenit 161(1)(2) dhe (4) të KPK-së të lexuar me nenin 23 të KPK-së (pika 7 e aktakuzës);

të pandehurit nuk janë shpallur fajtor dhe janë liruar nga të gjitha akuzat sipas aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P 1656/12 të datës 05.06.2013;

duke vepruar sipas ankesës së prokurores special nr. PPS 10/11 e parashtruar më datën 20.08.2013 kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P 1656/12 të datës 05.06.2013;

pas konfirmimit se ankesa u është dërguar avokatëve mbrojtës dhe shqyrtimit të përgjigjes në ankesën e ushtruar nga i pandehuri **R.H.2.** përmes avokatit të tij mbrojtës Sahit Bibaj;

pas shqyrtimit të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit nr. PPA/I 318/13 të datës 24.09.2013 dhe i paraqitur në Gjykatën e Apelit po të njëjtën ditë;

pas mbajtjes së seancës publike më datën 13.03.2014 në praninë e të pandehurve **A.A.** dhe **R.H.2.** dhe avokatit mbrojtës Arianit Koci për të pandehurin **S.L.** dhe avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj për të pandehurin **R.H.1.** dhe prokurorit të shtetit të apelit të EULEX-it Kari Lamberg;

pas këshillimit dhe votimit më 13.03.2014;

në pajtueshmëri me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të procedurës penale - Ligji nr. 04/L-123 (KPP);

merr këtë

AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurores special nr. PPS 10/11 e parashtuar më datën 20.08.2013 kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P 1656/12 të datës 05.06.2013

Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P 1656/12 i datës 05.06.2013.

ARSYETIMI

I. Historiku i gjertanishëm i lëndës

1. Prokurori i shtetit ngriti aktakuzën në lëndë më datën 15.08.2011. Aktakuza së pari u ndryshua më 17.10.2011. Gjykata e Qarkut të Prishtinës në të cilën është ngritur aktakuza e shpalli veten jo kompetente dhe lënda u referua tek Gjykata Komunale e Prishtinës.¹ Seanca për konfirmimin e aktakuzës është mbajtur më 16.03.2012. Më 03.05.2012 gjyqtari për konfirmim nxori ‘aktvendimin mbi konfirmimin e aktakuzës dhe pranueshmërinë e provave nr. KA 44/12’. Gjyqtari për konfirmim vetëm pjesërisht konfirmoi aktakuzën dhe, në mes tjerash, caktoi ri-hartimin e aktakuzës. Gjyqtari për konfirmim në atë kohë, hodhi poshtë në veçanti, akuzën për *Shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* për të gjithë të pandehurit. Prokurorja speciale ankimoj aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim më datën 04.05.2012. Kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Komunale të Prishtinës më 01.06.2012 vendosi mbi ankesën duke e pranuar pjesërisht ankesën e prokurores speciale. Kolegji prej tre gjyqtarësh ndryshoi vendimin e gjyqtarit për konfirmim dhe ri-ngriti akuzën e *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* e edhe akuzën e *Kanosjes* për të gjithë të pandehurit. Kolegji prej tre gjyqtarësh caktoi edhe hartimin sërishmi të aktakuzës.

2. Më 24.10.2012 prokurorja special ngriti aktakuzën e ndryshuar nr. PPS 10/11 në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Procedurat pas kësaj janë zhvilluar sipas kësaj aktakuze e cila njëherazi krijon edhe bazën e aktgjykimit të kundërshtuar (tash e tutje në tekst: aktakuza).

3. Më 1.1.2013 në Kosovë hyri në fuqi Ligji i ri mbi gjykatat bashkë me Kodin e ri të procedurës penale dhe Kodin e ri penal.

4. Shqyrtimi gjyqësor filloi në Gjykatën Themelore të Prishtinës më 15.04.2013. Seancat e tjera të shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur në datat vijuese: 16.04.2013, 17.04.2013, 18.04.2013, 19.04.2013, 22.04.2013, 24.04.2013, 25.04.2013, 26.04.2013, 20.05.2013, 21.05.2013, 27.05.2013, 28.05.2013, 31.05.2013 dhe 03.06.2013.

¹ Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. KA 557/11 i datës 09.11.2011.

5. Trupi gjykues nxori aktgjykimin në lëndë më datën 05.06.2013. Trupi gjykues i shpalli të pesë të pandehurit të pafajshëm për veprat e pohuara penale dhe i liroi ata nga të gjitha akuzat kriminale sipas nenit 364 paragrafi (1.1.) të KPP-së. Në pajtueshmëri me nenin 454 paragrafi (1) të KPP-së, pas nxjerrjes së aktgjykimit lirues, trupi gjykues caktoi se shpenzimet e procedurës penale në lidhje me të gjithë të pandehurit duhet të paguhen nga mjetet buxhetore.

6. Gjykata e Apelit tani po shqyrton ankesën e prokurores special kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

7. Gjykata e Apelit ka mbajtur seancë publike në lëndë më 13.03.2014 në praninë e të pandehurve **A.A.** dhe **R.H.2.** dhe avokatit mbrojtës Arianit Koci për të pandehurin **S. L.** dhe avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj për të pandehurin Rexhep Hoti dhe prokurorit të shtetit të apelit të EULEX-it Kari Lamberg. Të pandehurit e tjerë dhe avokatët e tyre mbrojtës kanë qenë të ftuar sipas rregullit në seancën e Gjykatës së Apelit por të njëjtit nuk kanë marrë pjesë.

II. Parashtrësat e palëve

(Ankesa)

8. Më 20.08.2013 **prokurorja speciale** paraqiti një ankesë mbi bazat e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 383 paragrafi (1.1.) në lidhje me nenin 384 paragrafi (1.7.) të KPP-së) dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në lidhje me pesë të pandehurit (neni 383 paragrafi (1.3.) në lidhje me nenin 386 të KPP-së).

9. Prokurorja special pohon se arsyetimi i Gjykatës Themelore është kontradiktor lidhur me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve. Se a përbënin apo nuk përbënin artikujt e xxx –it në 2009 kërcënim për shoqërinë kosovare, të gjithë dëshmitarët shfaqen mendimin e tyre personal dhe gjykata nuk arriti të sjellë ndonjë sqarim pse e ndoqi mendimin e paraqitur nga dëshmitarët B.H. dhe H. M. në vend të mendimit të kundërt të paraqitur nga dëshmitarët A.M, T. J, J. B. dhe xxx të Kosovës S. K.

10. Prokurorja speciale më tej paraqet se artikujt e xxx-it përbënin kërcënim në 2009 dhe ata përbënin një fushatë të përbashkët të medias. Gjykata Themelore nuk mori parasysh se nuk ishte vetëm etiketimi i **J. Xh.** si spiune e Serbisë që ishte thelbi i kësaj çështje, por që vargu i publikimeve të *Infopress-it* mbi këtë temë, brenda afatit të shkurtër që u nxorën, në mënyrë reciproke rriten dhe fuqizuan akuzat e pabaza kundër palës së dëmtuar dhe ekipit të saj. Kjo fushatë e akuzimeve të rrejshme dhe e kanosjeve të hapura ose indirekte ka kaluar nëpër një numër fazash nga data 30.05.2009 deri më 05.06.2009.

11. Trupi gjykues po ashtu tejkaloi detyrën e tij duke bërë një vlerësim dhe gjykim për programin “xxx”. Nëse ka pasur një provokim që nuk e parandalon veprën penale, kjo mundë të ndikojë vetëm në dënim nëse të pandehurit vërtet janë provokuar nga programi.

12. Prokurorja speciale paraqet se të gjitha elementet e veprës penale të *Kanosjes* janë të pranishme në këtë lëndë pasi që janë mbështetur me prova të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se personeli i *xxx* dhe pronari bartin të njëjtën përgjegjësi penale sikurse autorët bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatave Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj gjykata është dashur t'i dënojë të gjithë të pandehurit bazuar në pikat 5-8 të aktakuzës.

13. Më tej prokurorja speciale paraqet se gjykata ishte e paarsyeshme dhe nuk mori parasysh prova të rëndësishme kur nuk gjeti lidhje në mes të artikujve të botuar në *xxx* dhe kërcënimeve të mëvonshme dërguar **J. Xh.** dhe ekipit të saj përmes postes elektronike. Megjithatë kjo madje as nuk kërkohet për të vërtetuar se aty kishte elemente të veprës penale të *Kanosjes*. Kjo ishte vetëm provë mbështetëse për të treguar se sa serioze ishin kërcënimet.

14. Sa i përket akuzës së *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* (pikat 1-4 të aktakuzës), prokurorja speciale në ankesën e saj vë në pah se kolegji prej tre gjyqtarësh nga ish Gjykatës Komunale riktheu këtë akuzë pasi u hodh poshtë nga gjyqtari për konfirmim dhe në atë aktvendim kolegji sqaroi zbatimin korrekt të elementeve të nenit 158 paragrafi (1) të KPK-së. Pavarësisht këtij udhëzimi, Gjykata Themelore e shpalli publikimin nga *Infopress* si shprehje “krejtësisht të ligjshme” të mendimit të tyre për punën gazetareske të **J. Xh.** dhe ekipit të saj dhe aktgjykimi prandaj nuk adresoi në hollësi të mëtejme pikat e aktakuzës nga 1-4. Prokurorja speciale pohon se artikujt e *xxx-it* përbënin shkelje të statusit të barabartë të palës së dëmtuar sepse ata krijuan kufizime në liritë dhe të drejtat e viktimave. Për shembull **J.A.** ishte e detyruar që ta lë punën e saj si gazetarë për shkak të presionit të cilit ajo i ishte ekspozuar. Nuk kishte asnjë bazë ligjore të cilën *xxx* ka mundur ta shfrytëzojë sepse liria e shprehjes përfundon aty ku ushtrimi i saj cenon të drejtat fundamentale të të tjerëve. Artikujt janë botuar për ta ndaluar **J. Xh.** dhe ekipin e saj nga ushtrimi i gazetarisë hulumtuese. Rrjedhimisht të pandehurit duhet të ishin dënuar edhe mbi këtë bazë.

15. Në ankesën e saj prokurorja speciale analizon edhe deklaratat e dëshmitarëve duke vënë në dukje lëshimet e trupit gjykues i cili nuk arrin të marrë në konsideratë ato të cilat prokurorja speciale i përshkruan si aspekte të rëndësishme të deklaratave dhe nuk arrin të ketë në konsideratë të gjitha provat e rëndësishme. Njëherazi prokurorja speciale bën një analizë të deklaratave të të pandehurve duke pohuar se besueshmëria e këtyre deklaratave nuk ishte vlerësuar siç duhet nga trupi gjykues.

16. Prokurorja speciale i propozon Gjykatës së Apelit të pranojë ankesën e saj dhe t'i shpall të akuzuarit fajtor, t'i ngarkojë ata me të gjitha akuzat duke e ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar ose, si alternativë, të caktojë rigjykimin e tërësishëm ose të pjesshëm të lëndës.

(Përgjigja në ankesë)

17. Vetëm **mbrojtësi i të pandehurit R.H.2.** paraqiti përgjigje në ankesë. Përgjigja është paraqitur nga Sahit Bibaj, avokat mbrojtës i të pandehurit. Ai e kundërshton ankesën duke pohuar se ajo nuk është asgjë më shumë se sa një përsëritje e pretendimeve të prokurores

speciale të cilat janë shqyrtuar gjatë seancave të gjyqimit e që nuk janë mbështetur me asnjë provë. Ai vë në dukje se **R.H.2.** kurrë nuk ka qenë gazetar dhe e pranoi se ai e shkroi artikullin e kontestuar vetëm si një pjesë mendimi personal.

18. Avokati mbrojtës i referohet fjalës së tij përfundimtare dhe i propozon Gjykatës së Apelit të refuzojë ankesën e prokurores speciale si të pabazuar dhe të vërtetojë aktgjykimin e kundërshtuar.

(Propozimi i prokurorit të apelit të shtetit)

19. Në propozimin e tij të datës 24.09.2013 **prokurori i apelit i shtetit** u referohet neneve 40 dhe 42 të Kushtetutës së Kosovës dhe vëren se kufizimi me ligj i të drejtave të garantuara të lirisë së shprehjes, lirisë dhe pluralizmit të medias parashihet vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Neni 158 i KPK-së dënon sjelljen e mohimit ose kufizimit të kundërligjshëm të lirisë së shprehjes të mbrojtur me kushtetutë ose lirin e mediave mbi bazën e – në mes tjerash –mendimit politik ose mendimit tjetër. E njëjta dispozitë, megjithatë nuk e dënon tentimin ose shtytjen për të mohuar ose kufizuar lirinë e shprehjes, por vetëm mohimin aktual ose kufizimin e lirisë së shprehjes. Në fakt të pandehurit asnjëherë nuk u akuzuan as në lidhje me nenin 20 e as me nenin 24 të KPK-së. Prokurori i apelit kërkon nga Gjykata e Apelit të vlerësojë nëse sjellja e të pandehurve ka mundur së paku të kufizojë të drejtën e mbrojtur me kushtetutë të **J. Xh.** për t'i shprehur qëndrimet e saj politike dhe sociale dhe për të zhvilluar gazetarinë e saj hulumtuese. Fakti që shpifja dhe fyerjet nuk janë më vepra penale, si i tillë, nuk duhet ta ketë penguar trupin gjykues për të vlerësuar përgjegjësinë e të pandehurve për veprën penale nga neni 158 i KPK-së, sepse veprimi që ka për pasojë mohimin ose kufizimin e të drejtave të mbrojtura me kushtetutë nuk është e nevojshme të jetë në vete vepër penale.

20. Lidhur me pikat e veprës penale të *Kanosjes*, prokurori i apelit i shtetit është i mendimit se gjuha e katër artikujve të xxx është larg nga të qenit hiperbolik ose bile metaforik sikurse u sugjerua nga trupi gjykues. Pjesët e botuara përmbajnë vërejtje shpifëse dhe fyese ndaj **J. Xh.** por këto vërejtje nuk mund të konsiderohen *per se* kërcënime në kuptimin e komunikimit të qëllimit direkt apo indirekt për të shkaktuar dëm ndaj personit tjetër dhe për këtë arsye janë relevante vetëm për qëllim të padisë civile.

21. Megjithatë në artikullin e **R.H.2** “xxx” këto vërejtje arrijnë kulmin në fjalinë e fundit kanosëse që logjikisht dhe gramatikisht i referohen palës së dëmtuar. “Interpretimi i pastër gjuhësor” i përdorur nga trupi gjykues është i gabuar dhe i pamjaftueshëm për vlerësimin e kuptimit të fjalisë së fundit.

22. Në lidhje me artikullin “xxx”, kolegji përsëri u përqendrua në përmbajtjen shpifëse të artikullit, e humbi fokusin dhe nuk e vërejtë përmbajtjen kërcënuese të fjalive duke iu referuar të drejtës së plotë të shqiptarëve të ndershëm për të ndëshkuar “ambasadorin-horr” si terrorist.

Ndonëse është e vërtetë se nuk është gjetur autori i këtij artikulli, dhe sipas kodit penal në fuqi, pronari dhe botuesi nuk mundë të jenë penalisht përgjegjës sikurse që ishin më parë sipas nenit 28 të KPK-së, megjithatë referimi në këtë nen në aktgjykim është i tepërt sepse **R.H.1.** dhe **A.A.** janë akuzuar për *Kanosje* në bashkë-kryerje duke publikuar artikuj kërcënues. Neni 161 i KPK-së nuk i kufizon llojet e *actus reus* me të cilët mundë të bëhet një kanosje me kusht të provohet qëllimi i frikësimit ose i shkakutimit të shqetësimit, dhe bashkëkryerja në një kanosje nuk kërkon bashkautorësi apo marrëveshje paraprake në mes të të pandehurve. Bashkëkryerja kërkon vetëm kontribut substancial në kryerjen e veprës penale, sikurse në lëndën në fjalë që është publikimi i qëllimshëm, e në këtë mënyrë shpërndarje e mesazhit kërcënues.

23. Prokurori i apelit i shtetit e shtyn Gjykatën Apelit të vlerësojë pohimet e sjella nga prokurorja speciale në ankesën e saj dhe të tregojë nëse Gjykata Themelore ka përmbushur detyrën e saj për të gjykuar substancën e lëndës në lidhje me pikat e aktakuzës të *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* dhe lidhur me pikat e *Kanosjes*.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

III.I. Kompetenca e Gjykatës së Apelit dhe pranueshmëria e ankesës

24. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesat sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat - Ligji nr. 03/L-199.

25. Kolegji i apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053. 13. Ndaj përbërjes së kolegjit nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga palët.

26. Ankesa e prokurorit special është ngritur brenda afatit 15 ditor të paraparë me nenin 380 paragrafi (1) të KPP-së. Aktgjykimi i kundërshtuar i është dërguar prokurores speciale më datë 06.08.2013 sikurse është provuar me fletë dërgesë në shkresat e lëndës. Ankesa është paraqitur më 20.08.2013 ashtu sikurse dokumentohet edhe me vulën e shkrimores në ankesë.

III.II. Gjetjet mbi meritat

27. Ndonëse e paraqitur në kohë dhe e pranueshme, ankesa është e pabazuar.

28. Si bazë të parë ankimore, prokurorja speciale ngrit vërtetimin e pohuar të gabuar të gjendjes faktike dhe kundërshton gjetjet e Gjykatës Themelore mbi provat. Prokurorja speciale angazhohet në një analizë të hollësishme të provës së dëshmitarit në përpjekje për të treguar se Gjykata Themelore gabimisht u dha peshë dëshmitarëve të caktuar dhe neglizhoi dëshminë e të tjerëve. Më tej prokurorja special pohon se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj nuk e ka gjykuar plotësisht substancën e akuzës. Megjithëse prokurorja special nuk e ngrit si bazë ankimore të veçantë zbatimin e ligjit penal, nga arsyetimi i ankesës mund të nxirret përfundimi

se ajo, në veçanti në lidhje me pikat 1-4 të aktakuzës, kundërshton edhe interpretimin e miratuar nga Gjykata Themelore të ligjit penal.

Shkelja e pohuar substanciale e dispozitave të procedurës penale (neni 384 (1.7.) i KPP-së)

29. Prokurorja speciale pohon se Gjykata Themelore nuk arriti të gjykojë plotësisht substancën e akuzës.

30. Ankesa e prokurorit special është e pabazuar.

31. Shkelja sipas nenit 384(1.7.) të KPP-së ekziston kur Gjykata Themelore nuk arrin të adresojë të gjitha akuzat e përfshira në aktakuzë.² Kjo e rregullon lidhjen në mes të akuzave dhe aktgjykimit në aspektin kuantitativë. Gjykata, në mënyrë eksplicite, është e detyruar të nxjerrë një aktgjykim në lidhje me aktakuzën si tërësi duke mos e lënë as edhe një pjesë të vetme të përmbajtjes së aktakuzës të pavendosur.³

32. Gjykata Themelore në rastet përkatëse nxori vendimin mbi të gjitha akuzat të përfshira në aktakuzë, të ngritur më 24.10.2012. Gjykata Themelore e deklaroi aktgjykimin për pafajësi për të tetë pikat e aktakuzës pra i ka gjykuar plotësisht të gjitha akuzat në aktakuzë.

33. Prandaj nuk ka pasur shkelje sipas nenit 384 paragrafi (1.7.) të KPP-së.

34. Kolegji vëren se prokurorja speciale, megjithëse mbështetet në shkelje sipas nenit 387 paragrafi (1.7.) të KPP-së në mënyrë efektive kundërshton interpretimin ligjor të nxjerrë nga Gjykata Themelore dhe gjetjet e saj faktike duke pohuar se Gjykata Themelore nuk ka arritur të konsiderojë të gjitha elementet relevante të akuzave. Kjo do të shtjellohet në kapitujt përkatës vijues.

Shkelje të pohuara në lidhje me gjetjet faktike dhe ligjore të Gjykatës Themelore sa u përket dy grupeve të akuzave - *Kanosja* (neni 161(1), (2) dhe (4) i KPK-së) dhe *Shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* (neni 158(1) CCK)

² Komentimi i ligjit jugosllav mbi procedurën penale i cili përmbante të njëjtën dispozitë në nenin 364(1.7.) të LPP-së 1986 ka renditur këtë shembull (duke iu referuar një aktgjykimi të Gjykatës Supreme): Gjykata nuk e ka adresuar plotësisht lëndën e aktakuzës nëse vepron sipas akuzave se i akuzuari e sulmoi palën e dëmtuar dhe i shkaktoi asaj lëndime të lehta trupore në një tentim për të ia grabitur atij/asaj sendet dhe paratë, ajo konsideron se dashja nuk ka qenë e tillë dhe e liron atë nga vepra penale e grabitjes pa e shpallur atë fajtor për veprën e shkaktimit të lëndimit të lehtë trupor (Gjykata Supreme e Jugosllavisë Kž 38/70, më datë 2 mars 1979). Shih më tej në komentimin e LPP-së Komentimi i LPP-së 1986, MOMCILO GRUBAC & TIHOMIR VASILJEVIC, KOMENTIMI I LIGJIT MBI PROCEDURËN PENALE, 1982, BOTIMI I 2-TË, “SAVREMENA ADMINISTRACIJA”, BEOGRAD, KOMENTIMI I NENIT 364(1.7.).

³ Për shtjellim të hollësishëm shih: BRANKO PETRIC, KOMENTIMI I LIGJIT MBI PROCEDURËN PENALE 1986, BOTIMI I 2-TË, GAZETA ZYRTARE E RSFJ-SË BEOGRAD, KOMENTIMI I NENIT 364(1.7.).

Vlerësimi në lidhje me veprën penale të Kanosjes (neni 161(1), (2) dhe (4) i KPK-së)

35. Të pandehurit janë akuzuar për veprën penale të *Kanosjes* sipas nenit 161 paragrafët (1) dhe (2) dhe (4) të KPK-së.

36. Sipas të kuptuarit të Gjykatës së Apelit, prokurorja speciale i akuzoi të pandehurit kryesisht me formën e rëndë në paragrafin (4) të KPK-së, dhe në alternativë, me formën e përgjithshme të *Kanosjes* të përcaktuar me paragrafin (2) dhe paragrafin (1).

37. Neni 161 i KPK-së në pjesën relevante thotë se:

(1) Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër se do ta dëmtojë me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë dëmtim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria, se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

[...]

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën a pozitën e tij ose ndaj disa personave, nëse vepra penale shkakton shqetësim të madh ndaj tyre, nëse personi i kërcënuar, së këndejmi, për një kohë të gjatë është vënë në pozitë të rëndë ose nëse vepra penale është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit, kryerësi dënohet me burgim prej 3 muaj deri në tre vjet.

38. Kolegji konsideron se prokurorja speciale nuk ka arritur të vërtetojë dhe provojë elementet e formës së rëndë të veprës penale nga neni 161 paragrafi (4) të KPK-së.

39. Në radhë të parë prokurorja speciale nuk arriti të specifikojë se në cilat modalitete të kualifikuara të kryerjes u mbështet ajo. Si modalitet të vetëm që në mënyrë potenciale mund të aplikohet në kuadër të pretendimeve faktike të paraqitura nga prokurorja speciale, Gjykata e Apelit e pranon këtë: “nëse vepra penale shkakton shqetësim të madh ndaj personave, nëse personi i kërcënuar, së këndejmi, për një kohë të gjatë është vënë në pozitë të rëndë”.

40. Ndonëse prokurorja speciale argumenton për ndikimin të cilin artikujt e xxx-it e patën në jetën e **J.Xh.** gjendja faktike, sipas pikëpamjes së kolegjit, nuk e përbën atë që mund të cilësohet si “shqetësim i madh” në jetën e saj e as se është “vënë në pozitë të rëndë për një kohë të gjatë”.

41. Në aktakuzë prokurorja speciale nuk paraqet fakte ose prova të cilat do të lejonin kualifikimin nga neni 161 paragrafi (4) i KPK-së. Prokurorja special pohon se botimi i këtyre artikujve tek **J.Xh.** ka shkaktuar frikë dhe ankth për një kohë të gjatë, megjithatë kjo është vetëm perifrazim i dispozitës penale. Prokurorja speciale nuk paraqet *fakte* të cilat do të lejonin konkluzionin që po e nxjerr prokurorja (p.sh. informata specifike se si është manifestuar vet frika e pohuar, sa kohë në fakt zgjati, etj.).

42. Kolegji pranon se ka të ngjarë që pala e dëmtuar është ndjerë e kërcënuar dhe ka përjetuar ankth megjithatë kjo nuk ishte e një asi peshe saqë të futet brenda fushëveprimit të nenit 161 paragrafi (4) të KPK-së.

43. Duke vendosur se pretendimet faktike nuk arrijnë një intensitet të nevojshëm nga neni 161 paragrafi (4) të KPK-së dhe prandaj nuk e përmbushin këtë element të formës së rëndë të veprës penale, kolegji nuk ka nevojë të adresojë elementet e tjera dhe vlerësimin e Gjykatës Themelore në këtë aspekt për to.

44. Në vend të kësaj, kolegji gjithsesi duhet tani të vlerësojë nëse vepra penale e *Kanosjes* në formën e saj të përgjithshme ishte kryer nga të pandehurit përmes veprimeve të pohuara. Me fjalë të tjera, kolegji patjetër duhet të vlerësojë nëse të pandehurit, edhe pse jo përgjegjës për formën e cilësuar të veprës penale nga neni 161 paragrafi (4) të KPK-së, mund të konsiderohen përgjegjës për kryerjen e veprës penale nga neni 161 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së.

45. Para se të analizojë arsyetimin e Gjykatës Themelore dhe argumentet e ngritura në ankesë, kolegji gjithsesi duhet të sigurohet se ndjekja penale për këto vepra penale është (ende) ligjërish e mundshme.

46. Pas verifikimit të rregullave mbi parashkrimin për veprat penale nga neni 161 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së, kolegjit konsideron se të njëjtat janë të mbuluara me ndalim absolut mbi ndjekjen penale.

47. Kodi penal i Kosovës me nenin 90 ndalon ndjekjen penale nëse kjo e fundit nuk kishte filluar në një periudhë të caktuar kohore pas kryerjes së veprës penale (i ashtuquajtimi ndalim relativ mbi ndjekjen penale). Neni 90 paragrafi (1) i KPK-së përcakton këto periudha kohore të cilat janë në varësi nga maksimumi i dënimit të paraparë për një vepër të caktuar penale. Kodi penal përfshin dispozitat të cilat rregullojnë fillimin dhe ndërprerjen e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale në nenin 91 të KPK-së. Pas kësaj, Kodi penal ndalon ndjekjen penale në *çdo rast* kur kalon periudha kohore e përcaktuar dy herë për parashkrim në nenin 90 paragrafi (1) të KPK-së. Ky është i ashtuquajtimi ndalim absolut për ndjekje penale i rregulluar me nenin 91 paragrafi (6) të KPK-së. Kjo nënkupton se pas një periudhe të caktuar kohore, pavarësisht arsyeve për vonesë, i pandehuri nuk mundë të ndiqet penalisht për një vepër penale. Sipas nenit 91 paragrafi (1) të KPK-së, periudha e parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale.

48. Duke iu kthyer rrethanave të lëndës përkatëse, kolegji e konstaton këtë: Vepra penale e *Kanosjes* nga neni 161 paragrafi (2) të KPK-së bart dënimin me burgim në maksimum deri në 1 vit. Sipas nenit 91 paragrafi (6) të KPK-së lidhur me nenin 90 paragrafi (1) nën paragrafi 6) të KPK-së, ekziston ndalimi absolut mbi ndjekjen penale nëse kanë kaluar katër vjet nga kryerja e veprës penale. Veprat e pohuara penale në këtë lëndë janë kryer me botimin e artikujve

inkriminues respektivisht më 30.05.2009, 02.06.2009 dhe 05.06.2009. Pra periudha e parashkrimit ka kaluar më 30.05.2013, 02.06.2013 dhe 05.06.2013. Ndjekja penale e veprës penale sipas kësaj dispozite prandaj është e ndaluar.

49. I njëjti konkluzion vlen edhe për veprën penale të përcaktuar me paragrafin (1) të nenit 161 të KPK-së. Vepra penale bart dënimin në maksimum me burgim deri në 6 muaj. Sipas nenit 91 paragrafi (6) të KPK-së lidhur me nenin 90 paragrafi (1) nën paragrafi 6), ekziston ndalimi absolut mbi ndjekjen penale nëse kanë kaluar katër vjet nga kryerja e veprës penale. Edhe këtu vlen i njëjti arsyetim si më sipër, afati i parashkrimit ka kaluar më 30.05.2013, 02.06.2013 respektivisht më 05.06.2013. Ndjekja penale e veprës penale sipas kësaj dispozite prandaj është e ndaluar.

50. Për shkak se ndjekja e veprave penale nga neni 161 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së është e ndaluar, kolegji nuk ka nevojë të angazhohet në një analizë të mëtejme të vlerësimit të bërë nga Gjykata Themelore e as të argumenteve të ngritura në ankesë sepse ligjërisht të pandehurit nuk mund të ndiqen penalisht për këto vepra penale. Për më tepër kolegji vëren se parashkrimi për këto vepra penale tashmë kishte kaluar në kohën kur është shpallur aktgjykimi i kundërshtuar më 05.06.2013 e edhe kur është ushtruar ankesa.

51. Kolegji, si vërejtje të fundit në këtë pjesë, paraqet zhgënjimin e tij lidhur me stërzgjatje të trajtimit të kësaj lënde dhe vonesat e shkaktuara në ndjekje penale dhe gjykim gjë e cila përfundimisht ka shpënë në skadimin e parashkrimit.

52. Njëherazi kolegji vëren se faktet e pohuara nga prokurorja speciale nuk përbëjnë asnjë veprë tjetër penale e cila mund të ndiqet penalisht në mënyrë të ligjshme. Kolegji vë në dukje se veprat penale të fyerjes dhe shpifjes, të cilat do të mundë të aplikohen në këtë lëndë penale, nuk janë më vepra penale sipas Kodit të ri penal në fuqi prej 01.01.2013, sikurse tanimë është vënë re nga Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar. Në secilin rast, këto vepra penale, madje edhe nëse ende do të aplikoheshin kodi i vjetër penal, do të ishin përsëri në kohë të kaluar mbi bazat e njëjta sikurse u shtjellua në paragrafët e mësipërm.

Vlerësimi në lidhje me veprën e pohuar penale të Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158(1) të KPK-së)

53. Gjykata Themelore i liroi të pandehurit nga vepra penale e *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* (neni 158(1) i KPK-së). Gjykata Themelore gjeti se penalizimi nën këtë dispozitë shërben për të mbrojtur të drejtat themelore të personave përfshirë këtu lirin e fjalës. E drejta për shprehje publike është vazhdim i lirisë së fjalës dhe gazetarët në mënyrë të hapur mund të kritikojnë gazetarët e tjerë. Pikërisht këtë e kanë bërë të pandehurit kur e kanë kritikuar **J.Xh.** për programin “xxx”. Gjykata Themelore pra e refuzoi pohimin e prokurores speciale se me këtë

kritikë qëllimi i autorëve të artikujve, redaktorit dhe publicistit ishte për të ndaluar aktivitetet gazetareske dhe për të kufizuar të drejtën në fjalë të lirë të **J.Xh.** dhe personelit të saj.

54. Në ankesën e saj prokurorja speciale në mënyrë efektive paraqet se Gjykata Themelore nuk ka zbatuar në mënyrë korrekte nenin 158 paragrafi (1) të KPK-së. Ajo përcakton se janë plotësuar elementet për këtë veprë penale për secilin të pandehur.

55. Kolegji refuzon ankesën e prokurores speciale si të pabazuar.

56. Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë nxori konkluzionin se veprat e pohuara të të pandehurve të ngritura në aktakuzë nuk përbëjnë veprën penale të *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* sipas nenit 158 paragrafi (1) të KPK-së.

57. Neni 158 paragrafi (1) të KPK-së përmban me sa vijon:

“Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i mohon ose i kufizon liritë a të drejtat e banorit të Kosovës të parapara në Kornizën Kushtetuese dhe në ligjin në fuqi mbi bazën e dallimit në racë, në ngjyrë, në gjini, në gjuhë, në besimin fetar ose në ateizëm, në mendimin politik ose në mendimin tjetër, në prejardhje sociale ose kombëtare, në pronë, në lindje, në arsim, në statusit shoqëror ose sipas karakteristikave të tjera personale, të lidhjes me bashkësinë etnike ose gjuhësore në Kosovë ose kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i jep qytetarit të Kosovës çfarëdo privilegji ose përparësi mbi bazën e një dallimi ose përkatësie të tillë dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet.”

58. Kryerësi i kësaj veprë penale është “kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i mohon ose i kufizon liritë a të drejtat” banorit të Kosovës. Rrethi i kryerësve të kësaj veprë penale prandaj në praktikë do të jetë i ngushtë, që shtrihet vetëm tek personat të cilët janë në pozicion që në fakt të ndikojnë në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të individëve (personat zyrtar dhe, për shembull, personat përgjegjës në kompani, por edhe qytetarët e tjerë në qoftë se ata vendosin mbi të drejtat dhe liritë e dikujt tjetër). Këtu gjithsesi duhet të ekzistojë *një lidhje konkrete dhe e drejtpërdrejtë* në mes të veprës të të pandehurit dhe kufizimit rezultues të të drejtës së lirisë.

59. Kolegji thekson se neni 158 paragrafi (1) i KPK-së dënon mohimin *aktual* ose kufizimin e të drejtave dhe lirive në baza të karakteristikave personale. Dispozita shërben si pikë kundër diskriminimit. Ligji megjithatë nuk shkon deri në situatat ku të punësuarit e një gazete dhe anëtarë të publikut shprehin mendimet e tyre, sado të ashpra, rreth përbërjes së programit televiziv e edhe rreth gazetarëve dhe regjisorëve të atij programi. Për të pranuar interpretimin e

prokurores special të nenit 158 paragrafi (1) të KPK-së do të duhej të zbatohet shumë përtej qëllimit të tij.⁴

60. Pretendimet faktike në aktakuzë në asnjë mënyrë nuk e mbështesin pohimin se të pandehurit i kufizuan **J.Xh.** ose anëtarëve të personelit të saj lirinë e shprehjes apo ndonjë të drejtë tjetër përmes botimit të artikujve në xxx në maj dhe qershor 2009. Ndonëse kolegji pajtohet se artikujt e botuar kanë qenët të natyrës shpifëse e disa prej tyre madje kanë mundur të përfshijnë elementet e kanosjes, botimi i tyre si i tillë nuk ka pasur një ndikim të *drejtpërdrejtë* në **J.Xh.** apo personelin e saj në ushtrimin e të drejtave ligjore dhe kushtetuese.

61. Kolegji thekson se aktakuza nuk përmban fakte të cilat do të mbështesin cilësimin e pohuar. Pikat 1-4 sipas të cilave pohohet kryerja e kësaj veprë penale, prokurorja speciale në pjesën akuzuese të aktakuzës thjesht pohon se të pandehurit zhvillojnë një fushatë të medias kundër **J.Xh.** dhe personelit të saj duke botuar ose udhëzuar botimin e artikujve në xxx.

62. Që kjo veprë penale të ekzistojë, prokurorja speciale duhet të tregojë veprimet konkrete të të pandehurve të cilat drejtpërsëdrejti rezultuan në ndalimin e **J.Xh.** për të ushtruar të drejtat e saja ligjore dhe kushtetuese. Prokurorja special po ashtu do të duhet të tregojë qëllimin e drejtpërdrejtë ose të mundshëm të të pandehurve për këtë veprë penale. Asnjëra nga këto elemente bile as nuk janë pohuar e lëre më të jenë provuar nga prokurorja speciale. Deklarimi i prokurorisë se për shkak të trazirës së shkaktuar nga artikujt pala e dëmtuar e ka braktisur punën, në këtë aspekt është i pamjaftueshëm e as nuk mbështetet me prova sa i përket ndonjë lidhjeje të drejtpërdrejtë.

63. Pasi që vërtetoi se elementet e veprës penale sipas nenit 158 paragrafi (1) të KPK-së nuk janë plotësuar, Gjykata Themelore nuk qe e duhur që të angazhohet në ndonjë analizë ose arsyetim të mëtejshëm pra nuk ka pasur as shkelje të ligjit procedural në këtë aspekt.

64. Kolegji vërteton se Gjykata Themelore në mënyrë korrekte interpretoi nenin 158 paragrafi (1) të KPK-së dhe gjeti se veprimet e pohuara të të pandehurve nuk e përbëjnë këtë veprë penale.

Vërejtjet e kolegjit lidhur me cilësimin korrekt të veprave penale të pohuara kundër A.A. dhe R. H. 1.

65. Kolegji i liroi të pandehurit **A.A. dhe R. H. 1.** nga të tetë pikat e aktakuzës për veprat penale nga nenet 158 paragrafi (1) të KPK-së dhe 161 paragrafët (1), (2) dhe (4) të KPK-së, dhe u mbështetur në nenin 364 paragrafi (1.1.) të KPP-së.

66. Prokurorja Special i akuzoi dy të pandehurit me katër pika të veçanta të *Kanosjes* (neni 161(1) (2) dhe (4) të KPK-së) dhe katër pika të veçanta të *Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës* (neni 158(1) i KPK-së). Thënë ndryshe, prokurorja speciale pohoi se **A.A.**

⁴ E njëjta është vënë në dukje edhe nga gjyqtari për konfirmim i cili fillimisht refuzoi akuzat. Shih aktvendimin mbi konfirmimin e aktakuzës dhe pranueshmërinë e provave, KA 44/12, 03.05.2012, para. 81.

dhe R. H. 1. me botimin e secilit artikull në xxx kanë kryer veprë të veçantë penale. Gjykata Themelore ndoqi këtë qasje në vend se të cilësojë siç duhet veprimet si **një veprë penale e Kanosjes e kryer në vazhdimësi dhe një veprë penale e Shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës e kryer në vazhdimësi.**

67. Pikërisht veprimet e pohuara, sikurse pohohet nga vet prokurorja, formojnë një veprim të vazhdueshëm, prandaj cilësimi i duhur juridik është një veprë penale me veprime themelore të shumta.

68. Kolegji e bën këtë vëzhgim por edhe vë në dukje se nuk ka ndikim në rezultatin e çështjes penale pasi që të pandehurit kanë qenë të liruar nga të gjitha akuzat dhe mos shpallja fajtor është vërtetuar më pas nga Gjykata e Apelit për arsye të shtjelluara më sipër.

69. Në konkluzion kolegji e refuzon ankesën e prokurores speciale si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar lirues për të pesë të pandehurit.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar u kompletua më 28.04.2014.

Kryetari i kolegjit

Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Fillim Skoro
Gjyqtar

Procesmbajtësja

Beti Hohler
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS

Pakr 359/13

13.03.2014